



Prishtinë, 18 korrik 2012
Kodi i ZRRE-së: V_435_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 33 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,

në seancën e mbajtur me datë 18 Korrik 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I. **MODIFIKOHET Licenca për Gjenerim të Energjisë Elektrike** e dhënë ndërmarrjes “KelKos Energy” SH.P.K me numër licence ZRRE/Tr_01/Li_09/06, e cila ka qenë e vlefshme nga data 30.06.2009 deri 29.04.2024.
- I. Licenca e modifikuar (tani e tutje “Licencë për Gjenerim të Energjisë Elektrike”) me numër ZRRE/Tr_01/Li_09/12 do të hyjë në fuqi në datën e nxjerrjes së këtij vendimi dhe do të jetë e vlefshme deri me **24 Prill 2024**. Obligohet “KelKos Energy” SH.P.K që të zbatojë të gjitha dispozitat e licencës së modifikuar.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në dhjetor të vitit 2011 ka filluar procedurën për modifikim të licencës për gjenerim të energjisë elektrike për ndërmarrjen “KelKos Energy” SH.P.K, të transferuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 30.06.2009 nga **“Triangle General Contractors-INC.”-Dega në Kosovë, në “KelKos Energy” Sh.P.K**. Modifikimi ka filluar në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjeve në sektor të energjisë.
- Me 27 janar 2012 ZRRE ka publikuar në ueb faqen e saj draft – licencën e sipërpërmendur për komente nga palët e interesuara. ZRRE ka marrë parasysh edhe komentet e palëve të interesuara dhe përfundimisht ka harmonizuar dispozitat e kësaj licence me legjislacionin primar dhe sekondar në sektor të energjisë.
- Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkëngjitur licenca e modifikuar.*

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar